

Familjet e mëdha në Elbasan dhe Kontributi i tyre në Rilindjen Kombëtare në Fund të Shek.XIX fillim të Shek. XX

Received: 2 February 2026 / Accepted: 8 February 2026 / Published: 11 March 2026

© 2025 Zhuljeta KADILLI

Doi: doi.org/10.5281/zenodo.18967619

“Një atdhe përbëhet nga të vdekurit që e kanë themeluar dhe nga të gjallët që e vazhdojnë.”

Ernest Renan.

Abstrakt

Familjet e Mëdha janë një kategori shoqërore historike, të cilat janë formuar gjatë rrjedhës së shekujve, si rezultat i ndryshimeve ekonomike-shoqërore. Gjatë historisë në Shqipëri ka pasur tipe të ndryshëm të familjes, që nga familja patriarkale e deri tek familja feudale, çifligare, borgjeze e mikroborgjeze, fshatare, punëtore etj., me zakone tradicionale krahinore e lokale. Në një periudhë të caktuar të historisë, gjatë sundimit osman, kanë qenë edhe “Familjet e Mëdha” ose “Oxhaqet”, të cilat do të luajnë rol në zhvillimet ekonomike, politike e sociale të vendit. Origjina e tyre është e largët dhe mbase e panjohur mirë. Disa mund të jenë vazhduese e familjeve fisnike të periudhës së mëparshme, por kjo nuk do të thotë që nuk janë krijuar rishtazi duke shfrytëzuar mundësitë që iu jepte situata. Për të shkruar artikullin jemi mbështetur në burime arkivore dhe letërsi historiografike, të cilat i kemi parë në një kontekst të ri historik. Të tilla familje janë në Elbasan ajo e Biçakçinjve, Vërlaci, Kraosmani dhe Taushani. Këto familje kanë kontribut të madh gjatë Lëvizjes Kombëtare. Elbasani është shquar në një nga periudhat më interesante të historisë sonë të re, Rilindjes Kombëtare, për kontributin që ka dhënë në historinë politike e kulturore të Shqipërisë. Në të gjitha zhvillimet e kësaj periudhe, vepronte edhe një faktor tjetër i rëndësishëm, që padyshim ndërhynte në ngjarjet: bejlerët, feudalët çifligarë. Me ndikimin ekonomik, me ndikimin e tyre politik, si pranë Portës ashtu dhe pranë masave popullore të prapambetura, bejlerët qenë një faktor, pa të cilin nuk mund të shpjegohen dot

¹ Kolegji universitar “BEDER”, Email: zhkadilli@yahoo.com

ngjarjet që u zhvilluan në Shqipëri dhe në Elbasan, në veçanti, gjatë kësaj periudhe. Fakti që Lëvizja Kombëtare shqiptare gjente përkrahjen e bejlerëve liberalë të vendit, i jepte kësaj lëvizjeje një forcë që nuk e kishte në vendet e tjera ku haste në kundërshtim të hapur të këtij faktori, që mbante një qëndrim haptazi kundërshtues.

Fjalë kyçe: *Biçakçinjtë, Vërlaci, Lëvizje Kombëtare, Shpallja e Pavarësisë, klubet patriotike.*

Hyrje

Historia e qytetit të Elbasanit është e lidhur me ndërtimin e kalasë nga sulltan Mehmedi në vitin 1466. Më saktë do të shpreheshim me rindërtimin e kalasë në vitin 1466. Ky pohim qëndron, sepse këtu sulltan Mehmedi II zgjodhi vendin për të rindërtuar, më 1466, për “25 ditë”, muret rrethuese të kalasë mbi themelet e një kështjelle antike². Kalaja e rindërtuar u bë fillesa e qytetit të Elbasanit. Kalaja e rindërtuar shënoi përfundimin e një periudhe të gjatë e të jashtëzakonshme të periudhës romake-bizantine të Skampis në të gjitha aspektet, qoftë në atë ekonomik, urbanistik dhe arkitekturor³. Menjëherë filloi vendosja e banorëve të ardhur nga zonat përreth. Filloi të funksionojë edhe administrata e siguruar nga një garnizon i fuqishëm ushtarak⁴. Banorët e vendosur ishin fshatarë- zeytarë, të cilët përveç bujqësisë, u muarën me zeytari dhe tregëti. Vendosja e banorëve dhe administratës osmane krijuan premisa për ndryshime të thella në zhvillimin e një vargu procesesh të përgjithshme shoqërore, të cilat kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin historik të shqiptarëve. Me pushtimin turk filloi të përhapej myslimanizmi, ngrihen institucionet fetare. Si qendër e rëndësishme administrative e nohur me emrin sanxhak, zhvillohet si një qendër e rëndësishme zeytare, tregtare e kulturore⁵.

Këto ndryshime u shfaqën në mënyrë të theksuar në procesin e zhvillimeve kulturore, të shprehura dukshëm në mendësinë dhe mënyrën e jetësës, në urbanizëm dhe arkitekturë, në gjuhë, letërsi dhe art, në zeytari, artizanate dhe në kulturën popullore, përfshirë banimin, ushqimin dhe veshmbathjen. Të gjitha këto zhvillime kulturore mbështeteshin në një koncept të ri për jetën, respektivisht mbështeteshin në botëkuptime që buronin nga feja islame dhe kultura orientale islame⁶.

Gjatë sundimit osman në territorin shqiptar u krijuan ato familje që në histori njihen me emrin “Familjet e Mëdha”. Një pjesë e tyre mund të jetë vazhduese të familjeve fisnike të periudhës së mëparshme, por kjo nuk do të thotë që nuk janë krijuar edhe rishtazi duke shfrytëzuar mundësitë

² Franz Babinger, *Die Grudung von Elbasan, Sonderabdruck aus den Mitteilungen des Seminars für Orientalische Sprachen XXXIV.Bd(1931),II.Abteilung, Gedruckt in der Reichsdruckerei, Berlin (1931), f. 4.*

³ R.Pierini, *Recovering and improving Elbasan fortress, Krijimi dhe zhvillimi i fortifikimit të Elbasanit*, Pisa Univerity, 2008, f. 31.

⁴ Z.Shkodra, *Esnafet shqiptarë, në shek. XV-XX*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 197, f. 23.

⁵ *Elbasani-Enciklopedi*, Bashkia Elbasan, Shtëpia Botuese “Sejko”, Elbasan 2003, f. 150.

⁶ Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike, studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011, f. 15.

që ju jepte situata. Familjet e Mëdha shpesh janë quajtur edhe “Oxhaqe” apo “Dyer të Mëdha”. Po pse Oxhakë apo Dyer të Mëdha, cila është domethënia? Sipas literaturës së konsultuar mësojmë se, “*oxhaku dhe porta e shtëpisë ishin simboli më i rëndësishëm arkitektonik i aristokracisë së lartë qytetare, që paraqiteshin në forma të ndryshme dhe shumë origjinale*”⁷. Në disa qytete, ku sundimi i feudalëve ishte i fuqishëm, si p.sh., Tirana edhe Elbasani, ndërtimi i këtij elementi, nuk lejohej, sepse ai mbahej si e drejtë e vetme e parësisë feudale “oxhakëve”, siç thirreshin në gjuhën e popullit⁸ E rëndësishme është të theksojmë se pas dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XIX filluan të ndërtohen në masë (tymtoret) oxhakët mbi çati⁹. Këto familje gjatë periushës së sundimit osman do të luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale. Familjet e Mëdha në sanxhakun e Elbasanit janë: Biçakçinjtë, Vërlaci, Karaosmani dhe Taushani¹⁰.

1. Metodologjia dhe materiali

Materialet kryesore mbi të cilat bazohet punimi janë dokumente arkivore të botuara dhe pa të botuara si dhe botime të reja historiografike. Në mënyrë të veçantë dokumentet e lëna nga Lef Nosi ndihmojnë për të hedhur dritë sado pak mbi origjinën dhe veprimtarinë e tyre, veçanërisht gjatë Lëvizjes Kombëtare. Edhe Kujtimet e Eqrem Bej Vlorës na ndihmojnë, sidomos, për të kuptuar metodologjinë për përcaktimin e tyre. Metodologjia e punimit bazohet në vlerësimin e burimeve arkivore dhe botimeve historiografike që trajtojnë këtë problem. Sigurisht, këto burime arkivore dhe botime vlerësohen në një kontekst të ri historik dhe me një interpretim të ri kuptimor, duke i krahasuar me njëri tjetrin. Në ndihmë na vinë edhe rrëfimet e bashkëkohësve në ngjarje, të cilat duhen vlerësuar. Gjithashtu në interpretim është marrë në konsideratë edhe fakti që, burimet arkivore i përkasin një periudhë të largët historike, pjesa më e madhe të shkruara në osmanisht dhe përkthimi i tyre mund të krijojë ndonjë problem në pikëpamje gjuhësore. Njëkohësisht ajo që e bën të vështirë dhe e kufizon studimin, për të arritur në përfundime, lidhet me faktin se, pak dokumente ka për origjinën e Familjeve të Mëdha, ose nuk janë përkthyer nga osmanishtja.

⁷ Zija Shkodra, *Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984, f. 358.

⁸ Emin Riza, *Qyteti dhe Banesa Shqiptare e Mesjetës së Vonë*, Shtypur Kombinati Poligrafik, “Shtypshkronja e Re”, Tiranë 1991, f. 216.

⁹ Po aty.

¹⁰ AQSH, Fondi Lef Nosi Nr.32, D. 47, kutia 2, f. 10-35 dhe D. 39, f. 64-65.

2. Kuptimi mbi familjen si kategori shoqërore dhe historike

Përpara se të shkruajmë për familjet e çifligarëve dhe bejlerëve, apo “Familjet e Mëdha”, siç quhen shpeshherë në histori, apo në të folurën e përditshme, duhet të shpjegojmë në radhë të parë se: ç’është familja në përgjithësi si dukuri shoqërore dhe historike, e pastaj për to. Parë në këtë kontekst, familja është një bashkësi e vogël sociale, një grupim njëjërëzish, e formuar në bazë të bashkimit martesor, me lidhje të afrisë në gjak, a me birësim, me disa tipare të veçanta. Në brendësi e në funksionet e saj, si një dukuri e veçantë ekonomike e sociale, ka një farë autonomie nga shoqëria në tërësi¹¹.

Të tërë njerëzit, si rregull i përgjithshëm, jetojnë brenda bashkësisë familjare e që është një institucion social, po janë edhe pjesë e shoqërisë, e mjedisit social ku jetojnë, me disa të drejta e detyra të përcaktuara në bashkësi krahinore-fshatare, qytetare, shtetërore, etnike, kombëtare, bazuar në shtrirjen e tij në kufinjt e një territori të caktuar. Anëtarët e çdo familjeje si tërësi kanë të drejta e detyra që i ushtrojnë brenda bashkësisë së madhe shoqërore në fis, në fshat, në krahinë, në shtet, brenda etnisë a kombit. Nuk ka familje jashtë shoqërisë në tërësi ose jashtë bashkësisë sociale të madhe a të vogël ku është inkuadruar kjo celulë¹².

Në kuptimin filozofik, kur flitet për familje, mendohet familja biologjike, që në bazë ka lidhjen e gjakut, qoftë kjo edhe në breza, por sigurisht edhe lidhjet e tjera. Në këtë mënyrë ky koncept bëhet i plotë dhe i qenësishëm. Por, këtu nuk mund të lemë pa përmendur edhe marrëdhëniet ekonomike. Këto marrëdhënie marrin një rëndësi të madhe, pasi mundësojnë sigurimin material të familjes dhe vazhdimësinë e brezave. Edhe edukimi është pjesë e familjes. Gjithashtu marrëdhëniet ekonomike sigurojnë të mirat materiale dhe pasurinë, e cila të siguron edhe epërsi dhe ndikim në shoqëri. Ka ekzistuar dhe ekziston se ka qenë dhe është domosdoshmëri për jetën e njerëzve¹³.

¹¹ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Shtypur, Kombinati Poligrafik, “Shtypshkronja e Re”, Tiranë 1985, f. 255.

¹² Mark Tirta, *Etnologjia e Shqiptarëve*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Departamenti i Etnologjisë, “Geer”, Tiranë 2006, f. 228.

¹³ Mark Tirta, *Etnologjia e Shqiptarëve*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Departamenti i Etnologjisë, “Geer”, Tiranë 2006, f. 228.

Nga ana tjetër, familja, si dukuri shoqërore ka karakter historik, që do të thotë, se gjatë zhvillimit të shoqërisë në shekuj ka pësuar ndryshime të ndjeshme. Familja është një dukuri mjaft e lashtë në jetën e shoqërisë. Kuptohet ajo ka pësuar ndryshime nga koha në kohë.

Gjatë historisë në Shqipëri ka pasur tipe të ndryshëm të familjes, që nga familja patriarkale e deri tek familja feudale, çifligare, borgjeze e mikroborgjeze, fshatare, punëtore etj., me zakone tradicionale krahinore e lokale¹⁴. Forma sunduese e familjes ka qenë ajo patriarkale e fshatare e kushtëzuar nga vetë zhvillimet historike. Në një periudhë të caktuar të historisë, gjatë sundimit osman, kanë qenë edhe “Familjet e Mëdha” ose “Oxhaqet”, të cilat do të luajnë rol në zhvillimet ekonomike, politike e sociale të vendit. Pas çlirimit të vendit (1944), zhdukja e pronës private solli shndërrime të thella në konceptimin dhe funksionimin e familjes. Familja socialiste ishte ajo që zinte vendin kryesor në shoqëri. Parë në tërësi shihet se, familja është dukuri shoqërore si shumë institucione të tjera të kësaj natyre dhe padyshim në anë tjetër, është pjesë e shoqërisë në tërësi. Familja si dukuri shoqërore është mjaft e ndërlikuar.

3. Familjet e Mëdha të bejlerëve çifligarë në Elbasan si dukuri historike

Depërtimi Osman në tokat shqiptare, që filloi nga dekada e tetë e shek. XIV. Vendosja e pushtetit Osman në këto toka gjatë dekadave të mëvonshme, krijuan premisa për ndryshime të thella në zhvillimin e një vargu procesesh të përgjithshme shoqërore, të cilat kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin historik të shqiptarëve. Ky zhvillim qoftë në planin ekonomik apo social solli ndryshime edhe në konfigurimin e familjes.

Gjatë sundimit osman në territorin shqiptar u krijuan ato familje që në histori njihen me emrin “Familjet e Mëdha”. Një pjesë e tyre mund të jetë vazhduese e familjeve fisnike të periudhës së mëparshme, por kjo nuk do të thotë që nuk janë krijuar rishtazi duke shfrytëzuar mundësitë që ju jepte situata. Qeveria në fakt e pranoi ekzistencën e saj faktike.

Të dhënat arkivore për këto familje, origjinën e tyre, mënyrën e jetesës etj. janë të pakta, gjë që vështirëson njohjen e tyre. Më së shumti këto të dhëna janë nga pasardhësit e tyre, të cilët

¹⁴ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Shtypur Kombinati Poligrafik, “Shtypshkronja e Re”, Tiranë 1985, f. 255.

nëpërmejt kujtimeve kanë dhënë disa njohuri e vlerësime për to¹⁵. Ndonëse nuk janë të dhëna dhe burime parësore, ato merren në konsideratë, pasi plotësojnë një boshllëk në këtë drejtim. *“Gojëdhënat për zanafillën e pothuaj të gjitha “shtëpive të mëdha” shqiptare, janë një përzierje e legjendës me të vërtetën. Dhe se ç’përbindje të vërtete ka legjenda, kjo është e vështirë të thuhet. Sipas studiueses Holta Vrioni, në Shqipëri, ku populli dhe traditat e tij nuk janë prekur nga ndikime të tjera të huaja në atë masë sa edhe vendet e tjera të përparuara, atyre u duhet dhënë një rëndësi më e madhe, aq më tepër që burimet historike janë të kursyera e të pasakta”*¹⁶. Shpesh këto familje janë quajtur edhe Oxhakë apo Dyer Të Mëdha. Po pse këto familje janë quajtur “Oxhakë” apo “Dyer të Mëdha”, cila është domethënia? Sipas literaturës së konsultuar mësojmë se, *“oxhaku dhe porta e shtëpisë ishin simboli më i rëndësishëm arkitektonik i aristokracisë së lartë qytetare, që paraqiteshin në forma të ndryshme dhe shumë origjinale”*¹⁷. Në disa qytete, ku sundimi i feudalëve ishte i fuqishëm, si p.sh., Tirana edhe Elbasani, ndërtimi i këtij elementi, nuk lejohej, sepse ai mbahej si e drejtë e vetme e parësisë feudale “oxhakëve”, siç thirreshin në gjuhën e popullit¹⁸. E rëndësishme është të theksojmë se pas dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XIX filluan të ndërtohen në masë (tymtoret) oxhakët mbi çati¹⁹. Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, *“Oxhakët, apo Oxhakët Feudalë, janë Familjet e Mëdha pronare tokash, që përbënin oligarkinë sunduese feudale të Shqipërisë në shek. XVIII e deri në fund të shek. XX. Me shthurjen e sistemit të timarit, karakteristik për feudalizmin ushtarak, ishte zhvillimi i pronës së madhe feudale e çifligjeve që u përqëndrua në duart e Oxhakëve Feudalë. Secili Oxhak kishte vendosur edhe pushtetin e vet politik e ushtarak dhe e përforconte atë në dëm të pushtetit qendror, duke krijuar lidhje familjare, aleanca e tarafe brenda e jashtë krahinës. Porta, duke*

¹⁵ Sipas kumtit gojor të Nigjar Kozarja, pasardhëse e familjes së Biçakçinjve, kjo familje ka jetuar në Elbasan prej shumë brezash dhe sarajet i kanë pasur brënda në kala, në pjesën perëndimore të saj. Dy degët e Biçakçinjve, njëra e përfaqësuar nga Aqif Pasha dhe tjetra nga Dervish Beu kanë qenë në konflikt me njëra tjetrën. Ky konflikt mbase për probleme pasurie. Aqif Pasha gjyhashtu ka qenë në konflikt me familjen Vërlaci, ndonëse ishin në lidhje krushqie (datë 20.02.2025).

Sipas kumtit gojor të Elisabeta Toptanit, mbesë e Shefqet Vërlacit mësojmë se, kjo familje ka jetuar në Elbasan prej disa brezash. Shtëpinë e ka pasur aty ku ka qenë shtëpia e pionierit, më poshtë ka qenë haremi. Për origjinën e largët nuk dimë gjë. Hamendësismet për origjinën nga Vlora, pasi aty ka prona, nuk janë të vërteta. Prania e Shefqetit në Vlorë lidhet me vajzat e motrës të cilat mbetën jetime pas vdekjes së babait dhe nënës dhe ai u detyrua t’i ndihmojë e t’u gjendet pranë. Njohja me ambientin në Vlorë bënë që ai të blejë shumë prona aty (datë 12.11.2024).

¹⁶ Holta Vrioni, *Origjinat e pretenduara të oxhaqeve shqiptare*, në revistën Përpjekja, nr. 30-31, Tiranë 2013, f. 150.

¹⁷ Zija Shkodra, *Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984, f. 358.

¹⁸ Emin Riza, *Qyteti dhe Banesa Shqiptare e Mesjetës së Vonë*, Shtypur Kombinati Poligrafik, “Shtypshkronja e Re”, Tiranë 1991, f. 216.

¹⁹ Po aty.

pasur nevojë për forca ushtarake dhe për të siguruar grumbullimin e të ardhurave shtetërore, u detyrua të mbështetej tek më të fuqishmit prej Oxhakëve Feudalë, të cilët i lidhi deri diku pas vetes duke u besuar detyrat më të rëndësishme administrative e ushtarake dhe duke shfrytëzuar, nga ana tjetër, rivalitetin midis tyre. Ky rivalitet i pareshtur, që rridhte nga baza e saj ekonomike, e pengoi bashkimin e klasës feudale shqiptare në një front të vetëm, për t'u shkëputur nga vartësia e Stambollit e për të krijuar shtetin feudal shqiptar autonom”²⁰. Porta e Lartë i ndihmoi këto familje edhe për shërbimet e veçanta që i bënë. Në përfundim mund të pohojmë se është kjo mënyra e formimit të këtyre familjeve. Midis përfaqësuesve tipikë të klasës çifligare në Elbasan mund të përmenden Biçakçinjtë dhe Vërlacët dhe Karaosmanët. Ata zunë të kthehen në pronarë tokash që në fillim të shek. XVIII, por sidomos gjatë fundit shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX, ata morën titujt e bejlerëve dhe të pashallarëve, duke i shërbyer me besnikëri Portës së Lartë. Ata u bënë në këtë mënyrë zotër të shumë fshat-çifligjeve të Elbasani dhe të Myzeqesë²¹. Dyert e Mëdha të Elbasanit ose Oxhaqet, i korrespondojnë një kategorie të caktuar të shtresës së elitave tradicionale shqiptare të formësuara përgjatë historisë osmane shqiptare dhe më konkretisht, shtresës së feudalëve të mëdhenj shqiptarë, të cilët qenë njëherësh prijësit politikë të qeverisjes lokale dhe administratorë pasurish të patundshme. Dokumente relevante si vakëfnametë, sixhilatet e sherijes, materialet epigrafike, kronogramet, dorëshkrimet dhe materialet e tjera burimore të bollshme dhe të pakontestueshme, vërtetojnë se dyert e mëdha fisnike shqiptare si Bushatllinjtë e Shkodrës, Vlorajt e Kaninës, Biçakçinjtë dhe Vërlacët e Elbasanit etj., kanë ngritur thujse të gjitha objektet e kultit islamik, ato të kulturës dhe të arsimit në trojet shqiptare dhe kanë qenë bartëse të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe politik të vendit gjatë shekujve osmanë. Pikërisht në këto dyer është shestuar, është përpunuar dhe është përfituar mendimi politik shqiptar dhe mu këto dyer kanë qenë promotorë të veprimeve politike shqiptare gjatë këtyre shekujve²².

4. Familjet e Mëdha në Elbasan dhe Lëvizja Kombëtare

Elbasani është shquar në një nga periudhat më interesante të historisë sonë të re, Rilindjes Kombëtare, për kontributin që ka dhënë në historinë politike e kulturore të Shqipërisë. Në të

²⁰ Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f. 788.

²¹ Ligor K. Mile, *Çështje të historisë së agrare shqiptare*, fundi i shek. XVII- vitet 70 të shek XIX, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1984, f. 68.

²² Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike, studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011, f. 12.

gjitha zhvillimet e kësaj periudhe, vepronte edhe një faktor tjetër i rëndësishëm, që padyshim ndërhynte në ngjarjet: bejlerët, feudalët çifligarë. Me çifligjet e tyre të mëdha, me ndikimin ekonomik, me ndikimin e tyre politik, si pranë Portës ashtu dhe pranë masave popullore të prapambetura, bejlerët qenë një faktor, pa të cilin nuk mund të shpjegohen dot ngjarjet që u zhvilluan në Shqipëri dhe në Elbasan, në veçanti, gjatë kësaj periudhe. Fakti që Lëvizja Kombëtare shqiptare gjente përkrahjen e bejlerëve liberalë të vendit, i jepte kësaj lëvizjeje një force, që nuk e kishte në vendet e tjera ku haste në kundërshtim të hapur të këtij faktori, që mbante një qëndrim haptazi obskurantist, si p.sh., në Kosovë, Dibër, Berat etj²³.

Burimet historike të kohës tregojnë arsyet se përse bejlerët e Elbasanit në përgjithësi përkrahën çështjen kombëtare shqiptare. Arsyeja e parë lidhet me faktin se: “Të shtyrë nga interesi për të përballuar me forca masive popullore politikën e centralizimit administrativ që përpiquej të zbatonte Porta e Lartë në Shqipëri pas Tanzimatit. Edhe kanosja e vazhdueshme për humbjen e pronave me përmbysjen e Perandorisë, që kishin filluar t’i tronditeshin themelet, rreziku i rënies së autoritetit dhe ndikimi i tyre në popull bënë që, edhe përfaqësues nga shtresa të pasura të Elbasanit të përqaфонin Lëvizjen Kombëtare. Kjo mendojmë që është arsyeja e dytë. Ky fakt është një fenomen i ri dhe karakteristik për lëvizjen politike të këtij qyteti”²⁴. Bejlerët në Elbasan jo vetëm që e përkrahën Lëvizjen Kombëtare, por u vunë dhe në krye të saj. Bejleriët ishin fuqizuar për shkak të përkrahjes nga Porta e Lartë, si rezultat i shërbimeve që i kishin bërë. Veç kësaj, arsyeja mund të jetë përtej këtyre parashtrësive, dhe përtej kufijve të Perandorisë Osmane. Në botë kishin ndodhur ndryshime, të cilat ndonëse ngadalë kishin ndikuar edhe tek shqiptarët. “Nuk ka komb që të mos ketë nevojë të mësojë nga të tjerët”, pohonte John Stuart Mill²⁵. Gjithashtu Rendi i vjetër shoqëror, ku lindja përcaktonte pozicionin, po shpërbëhej²⁶ gjë që ishte kriteri mbi të cilën mbështetej Perandoria Osmane. Në këtë kontekst kjo klasë duhej të përgatitej për të ardhmen, të cilën në fakt nuk e dinin. Mbase kjo ishte arsyeja që nuk u përfshinë menjëherë dhe me të njejtën forcë e kurajo në të.

²³ Tatjana Haxhimihali, bot. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Aleks Buda*, Kujtime, Tiranë 2005, f. 24-25.

²⁴ Po aty.

²⁵ The economist, *Kundër tiranisë së shumicës: Paralajmërimi i John Stuart Mill vazhdon të jehojë edhe sot*, Gazeta Tema, datë 11 shkurt 2026, parë ora 15.30.

²⁶ Po aty.

Disa nga përfaqësuesit kryesorë të familjeve të bejlerëve çifligarë që morën pjesë dhe luftuan për çështjen kombëtare janë: Aqif Pashë Elbasani, Dervish Bej Biçaku, Shefqet Vërlaci, Hasan Bej Biçaku etj.

Në jetën e popujve, në rrjedhën e viteve dhe shekujve, ka ngjarje që, për domethënien e tyre, qëndrojnë si udhërrëfyes në udhëkryqet e historisë. E tillë është edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 10 qershor 1878, ku përfaqësuesit e kombit shpallën vendosmërinë për të luftuar për të drejtat e veta kombëtare²⁷.

Nga ky moment, Lidhja e Prizrenit bëhet pikë referimi për lëvizjen kombëtare. Lidhja e Prizrenit me vendimet e saj të rëndësishme u bë frymëzim për vazhdimin e lëvizjes. Nuk është rastësi që në qytetet kryesore filluan të ngrihen degë të saj. Nëpërmjet letërkëmbimit të Abdyl Frashërit me kryetarin e Lidhjes së Prizrenit Iljaz Pashë Dibrën, që datohet në 8 dhjetor të vitit 1878, informohemi se në Elbasan ishte krijuar një degë e Komitetit të Lidhjes së Prizrenit, të njohur me emrin Komiteti i Ndërlidhjes. Funkzioni kryesor i këtij Komiteti me qendër në Elbasan, konsistonte në koordinimin e veprimtarive midis komiteteve përkatëse të trevave të veriut dhe atyre të jugut. Në Elbasan, komiteti në fjalë njihej me emrin “Xhemijeti Ihtihadije” (Shoqëria e Besës)²⁸. Burimet dokumentare bëjnë me dije se në këshillin drejtues të degës së Elbasanit bënin pjesë përfaqësues të familjeve të mëdha feudale sikurse ishin: Ismail bej Vërlaci, Isuf bej Biçakçiu, Shazivar bej Karaosmani dhe myftiu i qytetit të Elbasanit Hasan Tasin efendi Alltoka në cilësinë e kryetarit të kësaj dege, ndërsa anëtarët të saj rezultonin përfaqësuesit e esnafëve të qytetit të Elbasanit²⁹. Mahmut Biçakçiu ka qenë një nga aktivistët kryesorë i degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan. Ai siguronte lidhje midis delegatëve të Lidhjes, që më së shumti kalonin nëpër Elbasan. Sipas Stavro Skëndit, i cili pranon faktin se kjo degë shërbente si një urë komunikimi dhe ndërlidhjeje midis veriut dhe jugut duke pohuar se:

²⁷ Tatjana Haxhimihali, *Dhimitër (Taq) Buda, Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare*, Biografi historike, Shtëpia Botuese “EMAL”, Tiranë 2025, f. 29-30.

²⁸ Majlinda Peza, Distertacioni në kërkim të gradës Doktor i Shkencave. me titull, “*Lëvizja politike arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*”. Qershor 2014, f. 27.

²⁹ Po aty.

“Kur u krijua Lidhja, të dy degët ajo e veriut dhe ajo e jugut, ishin marrë vesh që të takoheshin me anën e njerëzve të tyre të besuar në Elbasan, në Shqipërinë Qendrore”³⁰. Ndonëse ky plan nuk funksionoi sepse komitetet e ndryshme nuk kishin marrëdhënie të mira³¹, i rëndësishëm është fakti që, në Elbasan funksionoi dega e Lidhjes. Kjo tregon se fryma e lëvizjes kombëtare vazhdonte. Mahmut Biçaku si activist i saj kishte studiuar për mjekësi në Stamboll dhe ishte nga familja e Biçakçinjve³². Gjithsesi, duhet të pohojmë se nuk ka dokumente të mjaftueshme që mund të vërtetojnë veprimtarinë intensive apo kontributin real të bejlerëve të Elbasanit në Lidhjen e Prizrenit apo dhe degën e Elbasanit. Janë pak ato që disponojmë, për të nxjerrë përfundime, ishte ngjarje me dimensione të mëdha. nga ana tjetër po sipas Stavro Skëndi, “Familjet e Mëdha cifligare të Shqipërisë së Mesme, midis të cilëve edhe Elbasani, i kishin shpërbërë lidhjet e tyre të dobëta me Lidhjen Shqiptare. Tokat e tyre nuk ishin afër kufijve dhe ata nuk e ndjenin tryshninë e jashtme që t’i bënte të vetëdijshëm se Turqia nuk ishte në gjendje që t’i mbronte. Kur shkëmbyen mendime me delegatët e rretheve veriore, ata u bindën se programi për autonomi i Lidhjes jo vetëm do të çonte në konflikt me Turqinë, por do të dëmtonte gjithashtu interesat e tyre”³³. Pse kjo mendësi?

Duke pasur farefis në pozita të larta në ushtrinë turke dhe në shërbimin civil këta bejlerë feudalë e dinin sesi mendonte Stambolli dhe ata prisnin në çdo çast përdorimin e forcës për të shtypur Lëvizjen Shqiptare³⁴. Kjo analizë e studiuesit Stavro Skëndi tregon qartë për pozicionin e dyzuar të këtyre elementëve, të cilët nga njëra anë kishin interesat e tyre dhe nga ana tjetër ishte dashuria për vendin. Duhet të kemi parasysh që këta përfaqësues të këtyre familjeve kishin bërë karrierë në Perandori dhe ishin të privilegjuar. Gjithsesi, ngjarjet që po ndodhnin do të ndikonin në vetëdijen e tyre dhe nuk do të ishte e largët dita që të pozicionoheshin drejt, në mbështetje të çështjes kombëtare.

Zhvillimet politike të mëvonshme, që nga Kongresi i Dibrës (Nëntor 1878), lëvizja për autonomi, kryengritjet në vitet 1893-1895 e deri tek Lidhja Shqiptare e Pejës e kishin bërë të qartë situatën.

³⁰ Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, përkthyer nga Skënder Luarasi e Nestor Nepravishta, Tiranë: Phoenix, 2000, f. 95.

³¹ Po aty.

³² Bashkia e Qytetit, *Elbasani-Enciklopedi*, Shtëpia Botuese “Sejko”, Elbasan 2003, f. 65.

³³ Stavro Skëndi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, mendimi shqiptar..., vep. e cit., f. 99.

³⁴ Po aty.

Në mënyrë të veçantë Revolucioni Xhonturk pati ndikim të madh tek shqiptarët në përgjithësi dhe tek këta përfaqësues në veçanti.

Në Elbasan, pas Revolucionit Xhonturk, shqiptarizmi bëri hapa të rëndësishëm përpara, e kjo erdhi edhe për faktin se në mjedisin elbasanas një pjesë e bejlerëve largpamës (si Aqif Pasha, Mahmud Beu), që kur ishte bërë i qartë fundi i Perandorisë Osmane, kishin marrë në dorë flamurin e nacionalizmit shqiptar dhe ishin të interesuar për përhapjen e mësimit të gjuhës e kulturës shqiptare³⁵.

Qyteti ishte ngritur nga disa veprimtarë të shqiptarizmit në rangun e “qendrës” së kombit shqiptar, i ndodhur midis veriut e jugut³⁶. Pa ndonjë arsye të pashqyrtuar deri më sot, thuaj se gjithë inteligjenca e vendit vjen nga ky qytet³⁷. Në se studiuesi Auren nuk shpjegon dot arsyet e këtij realiteti, kjo lidhet mbase me njohuritë e pakta që kishte për Elbasanin dhe zhvillimin e tij përgjatë historisë. Që nga koha e themelimit (1466) Elbasani do të zhvillohet me shpejtësi, madje do të krijohet edhe njësi administrative. Zhvillimi do të jetë me ritme, sidomos, edhe përsa i takon tregtisë si rezultat i prodhimit të mallrave në zeje të ndryshme. Brenda një shekulli, që nga themelimi, do të bëhet një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike dhe administrative të vendit tonë. Ky zhvillim ekonomik ndikoi edhe në zhvillimin kulturor dhe arsimor. Në këtë kontekst Elbasani mbart një trashëgimi në drejtim të zhvillimit. Nuk janë rastësi ngjarjet me rëndësi mbarë kombëtare që u zhvilluan në Elbasan.

Mjafton që të kujtojmë se në Elbasan u organizua një kongres shqiptar, ishte hapur një shkollë normale, (për përgatitjen e mësuesve) që ishte kthyer në një institucion panshqiptar, edhe pse nxënësit më së shumti ishin nga Elbasani. Qyteti i Elbasanit, siç shprehet një studiues i huaj, ka një shkollë për mësues dhe një jetë karakteristike intelektuale. Atje ka madje edhe një klub akademik. Ndonëse një qytet i dobët ekonomikisht, ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën shpirtërore të vendit. Elbasani ka furnizuar me inteligjencë, ka krijuar shkolla dhe ka përgatitur mësues. Në korrik 1910 filloi të botohej edhe një gazetë³⁸. Historia e vendeve, popujve dhe

³⁵ Tatjana Haxhimihali, *Dhimitër (Taq) Buda, Veprimtar...*, vep. e cit., f. 148.

³⁶ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, “Marin Barleti”, Tiranë, 2009, f. 611.

³⁷ Sven Auren, *Shqipëria Orienti i Europës*, Botimet “Maluka”, Tiranë, 2025, f. 178-179.

³⁸ N. Clayer, *Në fillimet e ...*, vep. e cit., f. 611.

kombeve, në përgjithësi mundëson këndvështrime të ndryshme studimi, sjell profile dhe të dhëna që pasqyrojnë ide dhe mjedise të natyrës politike, shoqërore, intelektuale, kulturore etj. Në histori ato formësojnë realitete që u japin domethënie zhvillimeve historike, mundësojnë, gjithashtu, përmes këtyre zhvillimeve, ngjarje të rëndësishme, deri përmbysje dhe shndërrime rrënjësore³⁹. Si të tilla, historia ka kuotat e saj kulmore, ngjarjet e shënuara, datat, shenjat dhe simbolet që i spikatin ato. Nga ky pikëvështrim, datat e shënuara në historinë e një kombi përfaqësojnë hapësira kohore shumë më të gjera se një ditë, një muaj, një vit. Zakonisht ato shënojnë etapa të tëra, duke qenë, në të njëjtën kohë, pika kulmore në to⁴⁰. Gjatë periudhës së Rilindjes, Lëvizja Kombëtare shqiptare do të shfaqë specifikat e zhvillimit në tërë kompleksitetin e saj. Për më tepër, lëvizja për gjuhën dhe shkrimin e shqipes do të konsiderohej tashmë në fillim të shek. XX jo vetëm si një dukuri mirëfilli gjuhësore por, më së shumti do të marrë përmasat e një lëvizjeje të natyrës politike, duke reflektuar drejtpërsëdrejti në zgjidhjen e problematikave të përbashkëta.

Në periudhën e fundit të shek. XIX fillim i shek. XX në Elbasan janë bejlerët ata që dominojnë jetën politike. Përfaqësuesit e këtyre familjeve të mëdha feudale do të jenë protagonistët më kryesorë në zhvillimet politike dhe arsimore në qytetin e Elbasanit. Do të jenë këta përfaqësues të cilët edhe nga studiuesit e huaj do të konsiderohen si veprimtarët më kryesorë të shqiptarizmit në Elbasan.

Në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX Elbasani ishte qendër e rëndësishme për veprimtarinë politike dhe Lëvizjen Kombëtare në përgjithësi. Pas rebelimeve antiosmane në Elbasan në vitin 1897 dhe kërkesave kombëtare të parashtruara nga patriotët, delgatë nga Elbasani marrin pjesë në mbledhjet e fshahta të Kuvendit të Dibrës, mbajtur më 28 shkurt 1899, për t'u solidarizuar dhe për t'u bashkuar me Lidhjen Shqiptare të Pejës⁴¹. Por ngjarjet e mëdha që u zhvilluan në Elbasan në kuadër të Lëvizjes Kombëtare, janë Kongresi i Elbasani (shtator 1909) dhe hapja e shkollës Normale (dhjetor 1909) ku është e dukshme prania dhe kontributi i familjeve të Mëdha. Dervish Biçaku është ndër organizatorët kryesorë të Kongresit të Elbasanit, ku u zgjodh edhe kryetari i këtij kongresi. Ja si i përshkruan ditët e kongresit

³⁹ Tomorr Plangarica, *Universi i vlerave të munguara*, "Sejko", 2002, f. 49.

⁴⁰ Po aty, f. 17.

⁴¹ Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Shtëpia Botuese "albPAPER", Tiranë 2004, f. 156.

Gabriel Louis-Jaray. “Elbasani është në festë. Sot mbërrijnë delegatët nga të gjitha anët e Shqipërisë ndërsa nesër priten përfaqësuesit e qyteteve më të largëta. Në selinë e kryetarit të Kongresit, Dervish beut, ka ecejake të pareshtura. Çdo i sapoardhur vjen këtu për ta përshëndtur dhe bisedat kryhen në oborrin e madh ku Dervish beu pret të ftuarit. Në oborrin e madh, banorët e Elbasanit flasin e diskutojnë. Bashkëbisedojnë për ditën e madhe që po afron. Gjithë Shqipëria është atje dhe tani aty luhet fati i një populli. Sot bejlerët besojnë se arsimit do të jetë rigjallëruesi i energjive të popullit të tyre dhe ja si e perceptojnë ata organizimin e tij: asgjë nuk ekziston, gjithshka duhet bërë, duhet filluar me edukimin e mësuesve. Në Elbasan u vendos kështu ngritja e një shkolle Normale, e cila do të ishte njëkohësisht edhe pedagogjike për të nxjerrë mësues, edhe shkollë e mesme. Gjuha e mësimit do të jetë shqipja, si në të gjitha shkollat e fshatrave që do të ngrihen hap pas hapi”⁴². Krahas Dervish beut edhe Aqif Pasha ka ndihmuar qoftë në punimet e Kongresit apo dhe në çeljen e shkollës “Normale”⁴³. Njëkohësisht merrnin pjesë në komitetet e fshehta pas shpalljes së “Hyrjetit” dhe u bënë drejtues të klubeve të krijuara. U bënë gjithashtu përkrahës të kryengritjeve të mëdha të viteve 1910-1912. Interesat e tyre dolën nga caqet e lëvizjeve kulturore, që në momentet që po mbështesnin çetat në luftën kundër regjimit osman. Janë këto përfshirje që kanë dalluar këtë lëvizje në këtë qytet duke i dhënë një tjetër autoritet dhe dimension.

Gjithsesi, ajo që tregon angazhimin e klasës së bejlerëve në lëvizjen Kombëtare është përfshirja krahpërkrah Ismail Qemalit në Shpalljen e Pavarësisë. Ismail Qemali ishte në komunikim të drejtpërdrejtë me Aqif Pashën, Shefqet Vërlacin e të tjerë. Ja komunikimi me ta: Ja disa nga komunikimet e Ismail Qemalit me parinë e Elbasanit:

Durrës 9 vjeshta e Tretë 1328-1912

Ora 4.20 e natës

Shkëlqesiës Tija Aqif Pashës, Shefqet Beut e Irfan Beut

Elbasan

....Në një mbledhje ku do të bisedohen masa të jashtëzakonshme e do t’epet një vendim i premë, e gjindmja e Shkëlesiës Tija Aqif Pashës e Shefqet Beut, është e domosdoshme, edhe për këtë nuk mund të mendohet as ndoni shkak e arsye ndalimi. Prandaj, i shtrënguem nga nevoja e

⁴²Gabriel Louis-Jaray, *Shqipëria e panjohur*. Në Mbretërinë e re të shqiptarëve, Shtëpia Botuese “Dituria” Tiranë 2004, f. 45-47.

⁴³ Bashkia e Qytetit, *Elbasani-Enciklopedi.....*, vep. e cit., f. 60.

punës e i shtymun nga detyra patriotike, lutem qi t'urdhënoni të dy edhe pres përgjigjen tuaj Ismail Qemal⁴⁴.

Pas ftesës që Ismail Qemali ju bëri Aqif Pashës dhe Shefqet Beut (Vërlacit) për të qenë prezent në kuvendin e Vlorës, ata iu përgjigjën ftesës në këtë mënyrë:

Kryesiës së Kongresit të Indipendencës së Shqipniës

Vlonë

Ju bâjmë me ditë, se edhe Qemal Beu i Shehsuvar Beut, qi âsht prej Parësiës, u-emnue delegat, për me bashkëpunue me delegatët e tjerë t'Elbasanit e të Shqipniës.

Aqif Pashë Biçakçiu, Shefqet Bej Vërlaci.....⁴⁵.

Po të analizojmë me kujdes këtë lëtrëkëmbim kofident kuptojmë se Ismail Qemali vlerësonte këto figura, nisur jo vetëm nga prejardhja e tyre, por edhe nga veprimtaria patriotike e tyre e mëparshme. Nuk ishte pak një vlerësim nga një prej figurave kryesore të kombit, për këta persona. Përfaqësues dinjitoz i Familjeve të Mëdha që mori pjesë në lëvizjen kombëtare është Aqif Pasha (Biçakçiu).

Krahas shumë veprimtarive të tjera, pjesëmarrja e Aqif Pashës në Kongresin e Lushnjës më 1920 ishte tregues më sinjifikativ në këtë aspekt. Kongresi i Lushnjës është momenti i rëndësishëm që shenjoi jetën politike të Aqif Pashës, duke treguar dhe shprehur ndjenjat kombëtare. Ai bashkëpunoi me atdhetarët e tjerë lidhur me problemin më jetik të shtetit shqiptar, atë të humbjes së pavarësisë. Kjo ishte arsyeja që i çoi në mbledhjen e Kongresit të Lushnjës. Mori pjesë si delegate i Peqinit. Ai u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë dhe për një kohë u njoh si kryetar i tij. Aqif Pasha ishte i qartë dhe i vendosur se duke qenë të bashkuar të gjithë shqiptarët, kudo që jetonin e punonin do t'i mbronin të drejtat e tyre.

Në këtë aspekt Elbasani ka shumë për të treguar. Historia e Familjeve të Mëdha nuk është bardhë e zi. Ato kanë ulje e ngritje, por në përgjithësi kanë kontribute në çështjen kombëtare dhe kjo duhet vlerësuar.

⁴⁴ Dokumenta Historike PËR T'I SHËRBYE HISTORIËS TONË KOMBËTARE, E BOTON LEF NOSI, NJI HERË NË MUEJT, VIT i I rë- Mars 1924, Nr.1, ELBASAN Shtypshkronja "Elbasani" f. 10.

⁴⁵ Po aty, Maj 1924.Nr.3, f. 70.

5. Përfundime

Historia e vendeve, popujve dhe kombeve, në përgjithësi mundëson këndvështrime të ndryshme studimi, sjell profile dhe të dhëna që pasqyrojnë ide dhe mjedise të natyrës politike, shoqërore, intelektuale, kulturore etj. I tillë është edhe mjedisi i qytetit të Elbasanit, i cili sjell profile të natyrës politike, vlerësimi i të cilave flet për kontribute reale në historinë e qytetit të Elbasanit.

Në aspektin ekonomik në fund të shek.XIX e fillim të shek. XX, është një nga qytetet ku, marrëdhëniet feudale ndërthuren me ato kapitaliste, sigurisht këto të fundit në nivel të ulët zhvillimi. Në këtë kontekst, në strukturën sociale, vendin kryesor do ta mbajë klasa e bejlerëve-çifligarë, të cilët do të kenë rolin dominues në shoqëri. Kjo klasë do të formojë ato që në histori njihen si “Familjet e Mëdha” apo “Dyert e Mëdha”.

Në jo pak raste edhe “Oxhakë”. Përfaqësuesit e këtyre familjeve do të jenë të angazhuar në një nga periudhat më të rëndësishme të historisë së popullit tonë, në Lëvizjen Kombëtare. Në periudhën e fundit të shek. XIX fillim i shek. XX në Elbasan janë bejlerët ata që dominojnë jetën politike. Përfaqësuesit e këtyre familjeve të mëdha feudale do të jenë protagonistët më kryesorë në zhvillimet politike dhe arsimore në qytetin e Elbasanit. Do të jenë këta përfaqësues të cilët edhe nga studiuesit e huaj do të konsiderohen si veprimtarët më kryesorë të shqiptarizmit në Elbasan. Janë të shumtë shembujt në Elbasan që e vërtetojnë këtë gjë. Mjafton të përmendish Aqif Pashë Elbasanin, ke thënë gjithshka. Pavarësisht se kjo klasë në veprimtarinë e saj ka pasur ulje e ngritje dhe në mjaft raste kanë prevaluar interesat personale, një gjë është e sigurtë se, ata atdheun e deshën dhe luftuan për të, me mënyrën e tyre.

Është detyrim jo vetëm intelektual, por edhe qytetar, për t'i nxjerrë në pah një pjesë të këtyre vlerave dhe personaliteteve nga harresa dhe denigrimi shpeshherë i qëllimshëm, në periudhën e regjimit komunist. Në këtë aspekt, qyteti i Elbasanit ka për të treguar shumë. Janë modele dhe vlera të formësuara në institucione me dimension kombëtar veprimi. Njëkohësisht ka individë dhe personalitete nga Familjet e Mëdha që me kontributet e tyre kanë lënë gjurmë në historinë e vendit. Me historinë e këtyre familjeve është e lidhur historia e qytetit e kombit dhe Shqipërisë.

Literatura

1. AQSH, Fondi Lef Nosi Nr.32, D. 47, kutia 2, f. 10-35.
2. AQSH, Fondi Lef Nosi Nr.32, D. 39, f. 64-65.
3. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Shtypur, Kombinati Poligrafik, “Shtypshkronja e Re”, Tiranë 1985.
4. Auren, S.: *Shqipëria Orientali i Europës*, Botimet “Maluka”, Tiranë, 2025.
5. Babinger, F.: *Die Grudung von Elbasan, Sonderabdruck aus den Mitteilungen des Seminars für Orientalische Sprachen XXXIV.Bd(1931), II.Abteilung, Gedruckt in der Reichsdruckerei, Berlin (1931).*
6. *Elbasani-Enciklopedi*, Bashkia Elbasan, Shtëpia Botuese “Sejko”, Elbasan 2003.
7. Dokumenta Historike PËR T’I SHËRBYE HISTORIËS TONË KOMBËTARE, E BOTON LEF NOSI, NJI HERË NË MUEJT, VIT I I rë- Mars 1924, Nr.1, ELBASAN Shtypshkronja “Elbasani”.
8. Clayer, N.: *Në fillimet e Nacionalizmit Shqiptar*, botime “Përpjekja”, Tiranë 2009.
9. *Fjalori i Filozofisë*, Botime Enciklopedike, Seria e Fjalorëve Tematikë, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë 1982.
10. Haxhimihali, T.: bot. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Aleks Buda*, Kujtime, Tiranë 2005.
11. Haxhimihali, T.: *Dhimitër (Taq) Buda, Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare*, Biografi historike, Shtëpia Botuese “EMAL”, Tiranë 2025.
12. Jaray, G. L.: *Shqipëria e panjohur*. Në Mbretërinë e re të shqiptarëve, Shtëpia Botuese “Dituria” Tiranë 2004.
13. Krasniqi, N.: *Kontribute albanologjike, studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011.
14. Mile, K.L.: *Çështje të historisë së agrare shqiptare*, fundi i shek. XVII- vitet 70 të shek XIX, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1984.
15. Peza, M.: Distertacioni në kërkim të gradës Doktor i Shkencave. me titull, “Lëvizja politike arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914”. Qershor 2014.
16. Pierini, R.: *Recovering and improving Elbasan fortress, Krijimi dhe zhvillimi i fortifikimit të Elbasanit*, Pisa Univerity, 2008

17. Riza, E.: *Qyteti dhe Banesa Shqiptare e Mesjetës së Vonë*, Shtypur Kombinati Poligrafik, “Shtypshkronja e Re”, Tiranë 1991.
18. Shkodra, Z.: *Esnafet shqiptarë, në shek. XV-XX*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1978.
19. Shkodra, Z.: *Qyteti Shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984.
20. Tirta, M.: *Etnologjia e Shqiptarëve*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Departamenti i Etnologjisë, “Geer”, Tiranë 2006.
21. Vrioni, H.: *Origjinat e pretenduara të oxhaqeve shqiptare*, në revistën Përpyekja, nr. 30-31, Tiranë 2013.
22. The economist, Kundër tiranisë së shumicës: Paralajmërimi i John Stuart Mill vazhdon të jehojë edhe sot.